

VENDIM
Nr. 24, datë 19.2.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“COSMOGRAL” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.2.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 606/1 prot., datë 15. 2.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Cosmogral’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Cosmogral” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 606 prot., datë 8. 2.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Cosmogral” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3 gjerat “b”; si dhe për pikën 2.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacion në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “a”: të saktësohet objekti i aktivitetit në ekstraktin historik të regjistrit tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në mënyrë që të ketë të përfshirë dhe veprimtarinë e furnizimit për të cilën kërkon të licencohet nga ERE.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: të depozitojë në ERE vërtetimin që nuk ka asnjë detyrim në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- germa “c”: të saktësohet/sqarohet përcaktimi në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe mënyrën e planifikuar për financimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi